



PDK DHE ALEANCA KËRKOJNË KONSTITUIMIN E KUVENDIT, AKUZOJNË LV-në PËR BLLOKIM INSTITUCIONAL

FAQE 4-5



Deputetët e PDK-së dhe Aleancës u mbledhën sërisht të hënën në sallën plenare dhe kërkuan vazhdimin e seancës konstituive brenda 48 orëve, duke e akuzuar LV-në për bllokim

institucional. PDK-ja ka paralajmëruar se do t'i drejtohet përsëri kryesuesit të seancës sipas moshës, Avni Dehari, që ta thërrasë seancën në përputhje me

Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. ShBA-ja dhe BE-ja u ka bërë më herët thirrje partive politike që të gjejnë sa më shpejt një zgjidhje për krizën institucionale


**QEVERIA
NË DETYRË
E KURTIT I
DËRGOI VAGONËT
E TRENIT PËR
RIPARIM NË
SERBI** F. 3



**NIS "ORA
E PRITJES",
NUMËRIMI
SË PRAPTHI
NË PRITJE TË
KRERËVE
TË UÇK-së** F. 5



**NGA THATËSIRA TE PËRMBYTJET:
SI PO NDRYSHON KLIMA
DHE ÇFARË DO TË THOTË PËR
BUJQËSINË E KOSOVËS** F. 8



EKONOMI

SPORT



**KOSOVA MPOSHT ME PËRMBYSJE
MALIN E ZI NË PADEL** F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NË DITËN E PAVARËSISË SË UKRAINËS, ZELENSKY KËRKON MË SHUMË PRESION NDAJ RUSISË

KIEV, 24 GUSHT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, kërkoi më shumë presion ndërkombëtar ndaj Rusisë për ta detyruar atë të ulet në tryezën e negociatave. Në fjalimin e tij për Ditën e Pavarësisë së Ukrainës, ai u bëri thirrje Shteteve të Bashkuara, Evropës dhe Kinës që të angazhohen më shumë. “Besoj se Amerika do t’i kapërcejë të gjitha kundërtësitë dhe frikën që ka lidhur me Rusinë. Rusët duhet të sillen në tryezën e bisedimeve. Duhet të ndërmerren sanksione që do t’i bëjnë të ulërasin”, tha Zelensky në fjalimin e tij më 24 gusht - ditën kur Ukraina shënon 35-vjetorin e pavarësisë nga Bashkimi Sovjetik. “Evropa duhet të jetë Evropë. E bashkuar, ambicioze dhe e guximshme. Kina nuk duhet të vazhdojë më të heshtë”, shtoi ai. “Kina duhet ta dëshmojë ambicien e saj për të qenë një nga liderët botërorë, jo vetëm në aspektin ekonomik dhe teknologjik, por edhe si qytetërim - duke e bërë të qartë se asnjë diktator nuk ka të drejtë ta kërcënojë planetin me kokat e tij të vjetra bërthamore”, tha presidenti ukrainas.

Ndihmë e re nga Evropa

Pak para fjalimit të Zelenskyt, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, njoftoi se Ukraina do të marrë edhe 7

miliardë dollarë ndihmë ushtarake. “Në Ditën e Pavarësisë së Ukrainës, ne tregojmë mbështetjen tonë të palëkundur”, shkroi ajo në rrjetet sociale. Sipas von der Leyenit, fondet shtesë do të përdoren për “sisteme të mbrojtjes ajrore dhe raketore, raketa, municione dhe radarë, për të cilët Ukraina ka nevojë urgjente”. Gjatë ditës, vendet e të ashtuquajturit “Koalicion i Vullnetit” - ku bëjnë pjesë shtete evropiane, Kanadaja dhe vende të tjera - do të diskutojnë se si ta rrisin presionin ndaj Rusisë për t’i dhënë fund luftës në Ukrainë. Shumica e liderëve do të marrin pjesë në takim online, ndërsa kryeministri britanik, Andy Burnham, udhëtoi në Kiev. Kjo është vizita e tij e parë jashtë Britanisë që kur mori detyrën muajin e kaluar. “Rusia nuk duhet të ketë asnjë dyshim në vendosmërinë tonë. Ne nuk do të tërhiqemi derisa të arrihet një paqe e drejtë dhe e qëndrueshme”, tha Burnham. Pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia, i nisur në shkurt të vitit 2022, ka shkaktuar dëme të mëdha në vend. Mijëra civilë janë vrarë, miliona njerëz janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, ndërsa ekonomia ukrainase ka pësuar po ashtu. Që nga fillimi i luftës, Evropa dhe Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Ukrainës dhjetëra miliarda dollarë ndihmë ushtarake dhe



ekonomike. Por, sa më shumë që zgjat lufta, aq më shumë rriten shqetësimet se vendet perëndimore mund të lodhen nga mbështetja e vazhdueshme për vendin në luftë dhe ta zvogëlojnë ndihmën.

Ukraina kërkon mbështetje nga SHBA-ja

Ambasada amerikane në Kiev tha më 24 gusht se Uashingtoni do t’i forcojë “lidhjet ekonomike dhe të sigurisë” me Ukrainën. Megjithatë, furnizimet e drejtpërdrejta amerikane me pajisje ushtarake për Ukrainën

pothuajse janë ndërprerë që nga viti 2025. Kiev vazhdon të përfitojë nga mbështetja e rëndësishme e SHBA-së në fushën e inteligjencës, vëzhgimit dhe zbulimit. Por, atij gati se i kanë mbaruar rezervat e raketave interceptuese amerikane Patriot, që përdoren për mbrojtjen ajrore. Edhe planet që kompanitë ukrainase të marrin licencën për prodhimin e këtyre raketave duket se kanë ngecur. Më 23 gusht, Zelensky priti në Kiev dy senatorë amerikanë - demokratin Richard Blumenthal dhe republikanin James

Lankford. Ai i falënderoi Shtetet e Bashkuara për “mbështetjen e palëkundur nga të dyja partitë dhe të dyja dhomat e Kongresit”. Ai tha se në Kongres po vazhdojnë përpjekjet për të shtuar presionin ndaj Rusisë, përfshirë përmes një projektligji të senatorit tashmë të ndjerë, Lindsey Graham, që parashikon sanksione ndaj Rusisë dhe Iranit. Zelensky tha se i ka informuar senatorët edhe për sulmet e vazhdueshme ruse me raketa balistike dhe shtoi se Ukraina ka nevojë për më shumë kapacitete ushtarake për t’u mbrojtur nga këto sulme.

SHBA SHPALL ‘DITËN-D’ KUNDËR IRANIT, PRITET ‘OFENSIVË FINANCIARE’



UASHINGTON, 24 GUSHT - Sekretari i Thesarit i ShBA-së, Scott Bessent, ka njoftuar nisjen e asaj që ai e quan një “Ditë-D ekonomike” kundër Iranit, duke e përshkruar fushatën si ofensivën më të madhe financiare të drejtuar ndonjëherë ndaj një kundërshtari, me detaje të mëtejshme që do të publikohen më vonë. Bessent deklaroi se fushata ushtarake e presidentit të ShBA-së Donald Trump kishte “çmontuar ndjeshëm aftësitë ushtarake të Iranit dhe kishte dobësuar programin e tij bërthamor”.

Ai shtoi se administrata tani po “hyn në fazën përfundimtare” dhe se masat ekonomike fillojnë në agim. Objektivi, sipas Sekretarit të Thesarit të ShBA-së, është të “pritet çdo litar jetese ekonomik që mbështet regjimin tiranik derisa Teherani të qëndrojë i vetëm”. Komentet vijnë pas vërejtjeve të Trumpit, javën e kaluar. Në atë kohë, presidenti amerikan njoftoi në një postim në Truth Social “operacionin më shkatërrues ekonomik të ndërmarrë ndonjëherë kundër ndonjë vendi!”.

Pavarësisht të dy deklaratave, masat specifike nuk janë përcaktuar ende. Sipas skicës së Bessentit, paketa mund të përqendrohet në sanksione dytësore kundër kombeve dhe subjekteve që vazhdojnë të blejnë naftë iraniane, të përpunojnë financat e saj, të operojnë banka të lidhura ose të mbështesin transportin detar dhe kanale të tjera tregtare, të shtuara mbi bllokadën ekzistuese detare. Bessent është planifikuar të mbajë një konferencë për shtyp më vonë, për të njoftuar hapat konkretë.

Zjarr i fuqishëm në Nevada, dhjetëra mijëra banorë në rrezik

CARSON CITY, 24 GUSHT - Autoritetet në Nevada u bënë thirrje dhjetëra mijëra njerëzve të evakuohen dhe urdhëruan që shkollat të mbyten të mbyllura, ndërsa një zjarr i madh i shkaktuar nga era po përhapet me

shpejtësi në qytetin perëndimor të ShBA-së, Reno. Rreth 42,000 njerëz janë detyruar të evakuohen dhe 45,000 të tjerëve u është thënë të përgatiten për t’u larguar, njoftoi kryetarja e bashkisë së Renos, Hillary

Schieve. Zjarri filloi të shtunën dhe ishte rritur në 6,091 hektarë deri të dielën në mbrëmje, sipas InciWeb, një faqe interneti e qeverisë amerikane që gjurmon aktivitetin e zjarreve.

Nuk janë raportuar viktima, por të paktën gjashtë persona janë lënduar, ndërsa disa shtëpi janë shkatërruar, sipas mediave lokale. Zyrtarët thanë se zjarri ishte “i shkaktuar nga njeriu”, por nuk thanë se si filloi.



KURTI: 23 MBETJET MORTORE NË ZUBIN POTOK PËRKOJNË ME “GRUPIN E INTELEKTUALËVE”, IDENTIFIKIMI MUND TË ZGJASË DISA MUAJ

Prishtinë, 24 gusht- Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, i përfaqësuar nga kryesuesi Agron Limani dhe udhëheqësi i njësisë Kushtrim Gara, ka prezantuar raportin përmbledhës për gërmimet në tri lokacione në fshatrat Kalludër dhe Jabukë, të komunës së Zubin Potokut, që rezultuan me gjetjen dhe zhvarrosjen e mbetjeve mortore, që vlerësohet se u përkasin së paku 23 personave, të cilët dyshohet të jenë viktimat të zhdukjes me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i cili ishte i pranishëm në këtë prezantim të raportit, ka theksuar se tashmë kanë hyrë në një fazë tjetër, atë të identifikimit. “Numri 23 përkon me atë që njihet si ‘Grupi i intelektualëve’, të cilët më 19 prill të vitit 1999, u ndaluan, u rrëmbyen dhe u pushkatuan nga forcat armike të Serbisë, që u përpoqën të fshehin dhe të zhdukin gjurmët e këtij krimi gjenocidal. Por, procesi i identifikimit në tërësi mund të

marrë edhe disa muaj kohë, andaj vetëm atëherë do të mund të flasim me saktësi të plotë së për kë bëhet fjalë dhe, bashkë me familjet, t’u japim një lamtumirë dinjitoze dhe nga një varr me emër e mbiemër”, është shprehur Kurti. Ai ka thënë se qindra familje kërkojnë zbardhjen e fatit të më të dashurve të tyre, por edhe drejtësi. “Zbardhja e fatit sikurse edhe drejtësia, u janë mohuar dhe po u mohohen nga Serbia, që duke fshehur e duke mos i pranuar krimet, si dhe duke refuzuar të hapë arkivat e duke i klasifikuar ato, synon të tjetërsojë të vërtetën dhe t’i ikë përgjegjësisë. Më shumë se kurdo tjetër, në momente si ky, faktorët ndërkombëtarë duhet ta shtojnë tryshinë ndaj fqinjit tonë verior, që të zbatojë Deklaratën për Personat e Zhdukur me Dhunë të dakorduar në Bruksel më 2 maj 2023, duke hapur dhe vënë në dispozicion arkivat shtetërore, që mund të çojnë në zbardhjen



e fatit të të pagjeturve”, ka deklaruar Kurti. Kryeministri në detyrë ka thënë se është vendimtare për procesin që të hapet arkiv i Brigadës së Motorizuar 37 të Ushtrisë së Jugosllavisë, e cila ka kryer masakra, posaçërisht

në Drenicë, por edhe gjithandej Kosovës, dhe dosja e së cilës para 12 vjetësh është klasifikuar për 30 vjet. “Familjet që kanë pritur 27 dhe 28 vjet, nuk mund dënohen me pritje, ankth e dhimbje, edhe për 18 vjet të tjera. Andaj tryshnia

ndërkombëtare është jetike në këtë proces. Dosjet e arkivuara dhe të klasifikuara të Brigadës së Motorizuar 37 të Ushtrisë së Jugosllavisë, duhet të hapen tash nga shteti i Serbisë, pra sivjet, në vitin 2026, e jo në vitin 2044”, ka thënë Kurti.

GJYKATA RRËZON VENDIMIN E SHBA-së PËR PEZULLIMIN E VIZAVE TË MIGRIMIT NGA 75 VENDE, PËRFSHIRË KOSOVËN

UASHINGTON, 24 GUSHT - Një gjykatëse federale ka rrëzuar pezullimin e vendosur nga administrata amerikane për shqyrtimin e vizave për migrantë nga 75 vende, përfshirë nga Kosova. Sipas Gjykatës së Qarkut Jugor të Nju Jorkut, vendimi i administratës amerikane vlerësohet i “kundërligjshëm” dhe gjykatësja Jeannette Vargas tha se sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka “tejkalluar autoritetin e tij” kur e mori vendimin.

Vendimi, që hyri në fuqi në janar të këtij viti, pezullonte shqyrtimin e aplikimeve të vizave për migrantë nga shtetasit e 75 vendeve, përfshirë nga Kosova, Shqipëria,



Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovina. Po ashtu, në këtë ndalesë u përfshin edhe shtetet sikurse Afganistani, Egjipti, Brazili, Iraku, Nigeria, Somalia,

Tajlanda dhe Jemeni. “Departamenti i Shtetit do të pauzojë shqyrtimin e vizave për emigrantë nga 75 shtete, migrantët nga të cilët marrin ndihma sociale nga populli

amerikan në nivele të papranueshme. Kjo ndalesë do të jetë në fuqi deri kur ShBA-ja të sigurohet që migrantët e rinj nuk do të përfitojnë nga populli amerikan”, shkroi Departamenti amerikan i Shtetit në X në janar kur njoftoi për vendimin. Por, Vargas vendosi se zyrtarët konsullorë u udhëzuan gabim për të refuzuar vizat e migrimit duke u bazuar vetëm në vendin e origjinës së aplikuesit. Administrata amerikane mund ta apelojë vendimin e gjykatës federale. Para se të publikohej vendimi, më 4 janar, presidenti amerikan, Donald Trump, e publikoi në Truth Social një listë të vendeve migrantët e të cilave marrin

ndihmë sociale nga Qeveria amerikane. Kosova ishte në mesin e tyre, pasi 46 për qind e emigrantëve kosovarë që jetojnë në ShBA marrin ndihmë sociale nga Qeveria atje, sipas listës së publikuar nga presidenti amerikan. Trump gjatë fushatës presidenciale për mandatin e dytë në Shtëpinë e Bardhë premtoi se do të dëbonte miliona migrantë pa dokumente dhe administrata e tij ka ndërmarrë një sërë veprimesh që kur ai u kthye në Shtëpinë e Bardhë, masa që synojnë përshpejtimin e dëbimeve dhe uljen e numrit të kalimeve të paligjshme kufitare.

Nis “Ora e Pritjes”, numërimi së prapthi në pritje të krerëve të UÇK-së

Prishtinë, 24 gusht 2026 - Në Bulevardin “Nëna Terezë” në Prishtinë ka nisur “Ora e Pritjes”, aktiviteti i platformës “Liria ka Emër” në bashkëpunim me komunën e Prishtinës, përmes të cilit ka filluar numërimi së prapthi drejt 16 shtatorit, datës kur pritet vendimi final për ish-krerët e UÇK-së në Hagë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Në shesh është vendosur një

ekran gjigant, i cili do të numërojë ditët, orët, minutat dhe sekondat deri më 16 shtator, në shenjë pritjeje dhe mbështetjeje për çlirimtarët. Në hapje të aktivitetit foli përfaqësuesi i platformës “Liria ka Emër”, Ismail Tasholli, i cili tha se “Ora e Pritjes” simbolizon pritjen e qytetarëve të Kosovës për drejtësi dhe kthimin e ish-krerëve të UÇK-së në atdhe. Nënkrëtarja e Prishtinës, Besianë Musmurati, e cila foli

në cilësinë e bashkëorganizatores, theksoi se Kryeqyteti do të jetë pjesë aktive e aktiviteteve në mbështetje të historisë dhe vlerave të luftës çlirimtare. Në aktivitet foli edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, i cili përsëriti mbështetjen për aktivitetet e platformës “Liria ka Emër” dhe bëri thirrje për bashkim qytetar përtej dallimeve politike.



PDK DHE ALEANCA KËRKOJNË KONSTITUIMIN E KUVENDIT, AKUZOJNË LV-në PËR BLOKIM INSTITUCIONAL



Deputetët e PDK-së dhe Aleancës u mbledhën sërish të hënën në sallën plenare dhe kërkuan vazhdimin e seancës konstituive brenda 48 orëve, duke e akuzuar LV-në për bllokim institucional. PDK-ja ka paralajmëruar se do t'i drejtohet përsëri kryesuesit të seancës sipas moshës, Avni Dehari, që ta thërrasë seancën në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. ShBA-ja dhe BE-ja u ka bërë më herët thirrje partive politike që të gjejnë sa më shpejt një zgjidhje për krizën institucionale

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 GUSHT- Deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të Aleancës të hënën në orën 11:00 kanë qenë prezentë në sallën plenare të Kuvendit të Kosovës, ku do të duhej të mbahej vazhdimi i seancës konstituive. Deputetët e dy grupeve parlamentare kanë kritikuar në Lëvizjen Vetëvendosje dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, lidhur me situatën institucionale në vend dhe bllokadën e Kuvendit të Kosovës. Deputetja e PDK-së, Sala Jashari, nga foltorja e Kuvendit të Kosovës, i ka bërë thirrje kryesuesit të seancës sipas moshës, Avni Deharit, që ta thërrasë seancën në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. “Prandaj, sot nuk po ju kërkoj të hiqni dorë nga mandati që ju kanë dhënë

qytetarët. Po ju kërkoj ta respektoni atë. Kthejuni përgjegjësisë. Kthejuni institucioneve. Kthejuni punës. Sepse Kosova ka nevojë për më shumë besim mes duarve që e ndërtojnë atë. Dhe Kosova nuk ka kohë për të prituri”, theksoi Jashari. Ajo drejtoi kritika ndaj deputetit Albin Kurti dhe Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët i kanë uzurpuar institucionet e nivelit qendror, që po përpiqen të marrin më shumë kompetenca edhe nga komunat. “Dhe pyetja është shumë e thjeshtë: A është kjo mungesë besimi ndaj institucioneve lokale, apo është dëshirë për të pasur gjithnjë e më shumë pushtet? Sepse nëse nuk arrin ta konstituosh Kuvendin, nëse nuk arrin të ndërtosh kompromis me të paktën një pjesë të përfaqësimit politik të qytetarëve, si mund të pretendosh se përgjigjja për një shtet më funksional është të marrësh edhe më shumë kompetenca?”, tha Jashari.

PDK-ja ka bërë me dije se do t'i drejtohet përsëri kryesuesit të seancës për nga moshë, Avni Dehari, me kërkesën për vazhdimin e seancës konstituive brenda 48 orëve. Ndërkohë, deputetja e Aleancës, Teuta Haxhiu, ka akuzuar LV-në për, siç tha ajo, keqpërdorim të institucioneve. “Deputeti Kurti vazhdon ta mbajë të bllokuar Kuvendin. Kosova po përballë me krizë të rëndë institucionale”, deklaroi Haxhiu. Ajo ka paralajmëruar gjithashtu se, sipas saj, LV-ja mund ta çojë vendin në zgjedhje. Haxhiu ka kritikuar edhe çështjen e renovimit të vagonëve të trenave në Serbi, duke e lidhur atë me bashkëpunimin institucional me këtë shtet. “Qytetarët nuk kanë besuar kurrë se kjo Qeveri, pas disa muajsh pas vrasjes së rrethitit Enver Zymberaj, shkon në Serbi dhe rregullon vagonë”, tha ajo. Ndërkaq, deputetja tjetër e Aleancës, Time Kadrijaj, ka kërkuar nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, që të rikthehet në Kuvend bashkë me deputetët e LV-së. Kadrijaj, në një adresim për media nga holli i Kuvendit, ka akuzuar Qeverinë për bashkëpunim me Serbinë. Ajo ka pretenduar gjithashtu se Kurti synon të rrisë numrin e ministrave për të krijuar, sipas saj, hapësirë për sistemimin e militantëve partiakë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

kanë ritheksuar thirrjen ndaj udhëheqësve politikë të Kosovës që të bashkëpunojnë për formimin e institucioneve në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit tha se udhëheqësit politikë duhet të punojnë së bashku për tejkalimin e ngërçit institucional. “Ky ngërç i vazhdueshëm politik po rezulton në mundësi të humbura për Kosovën. Është koha që udhëheqësit t'i japin përparësi progresit dhe stabilitetit në të mirë të të gjithë qytetarëve”, tha zëdhënësi. Kjo është thirrja e dytë e ngjashme e bërë nga pala amerikane brenda pak kohësh, pasi kërkesë të ngjashme për bashkëpunim kishte shprehur edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë më 12 gusht. Thirrja e re amerikane vjen në kohën kur Kuvendi i Kosovës ende nuk është konstituuar pas zgjedhjeve të 7 qershorit. Seanca konstituive e legjislaturës së re nisi më 6 gusht. Deputetët bënë betimin, por procesi nuk kaloi në fazën e zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit. Albin Kurti, në cilësinë e kreut të Lëvizjes Vetëvendosje, kërkoi kohë shtesë për konsultime me partitë, duke thënë se ende nuk kishte marrëveshje për

formimin e institucioneve. Seanca u ndërpre dhe u caktua të vazhdonte më 8 gusht. Edhe në vazhdimin e 8 gushtit nuk pati kandidaturë për kryetar të Kuvendit. Kurti kërkoi konsultime me partitë, por pas kësaj deputetja e Aleancës, Time Kadrijaj, hodhi vezë në drejtim të tij. Pas këtij incidenti kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ndërpreu punimet. Që atëherë, procesi ka mbetur i bllokuar. Dehari ka thënë se seanca e radhës do të thirret kur partitë të arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e krizës, duke argumentuar se pa një marrëveshje politike nuk ka kuptim që seanca të mbahet vetëm si formalitet. Ndërkohë, në përpjekje për të gjetur një zgjidhje politike, më 18 gusht Kurti u takua me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, me fokus të zgjedhja e presidentit të ardhshëm. Pas takimit, të dy thanë se kishte vullnet për të gjetur një zgjidhje, ndërsa u pajtuan që në takimin e radhës të shqyrtojnë emra konkretë për president. Përveç ShBA-së, edhe Bashkimi Evropian u ka bërë më herët thirrje partive politike që të gjejnë sa më shpejt një zgjidhje për krizën institucionale. BE-ja ka paralajmëruar se ngërçi politik dhe vonesat në zbatimin e reformave mund ta kufizojnë aftësinë e Kosovës për të përfutur nga mbështetja evropiane.

MUHAMET MAVRAJ: KURRË NUK KEMI PASUR FRIKË NGA DREJTËSIA DHE NUK DO TË KEMI



Profesori dhe publicisti Muhamet Mavraj ka reaguar përmes një postimi në 'Facebook', duke thënë se krijuesit e historisë nuk mund të fshihen apo të nxirren prej saj nga gjykatat, qeveritë apo individë të caktuar. “Kurrë nuk kemi pasur frikë nga drejtësia dhe nuk do të kemi”, ka shkruar Mavraj. Ai ka theksuar se, pavarësisht përpjekjeve për rishkrimin e historisë, askush nuk mund t’i largojë prej saj ata që e kanë krijuar atë. “Asnjë gjyq, asnjë qeveri, asnjë kopuk nuk ka mundur e nuk mund, asnjëherë dhe askund, t’i nxjerrë nga historia krijuesit e saj. Nuk munden as ata që po përpiqen ta rishkruajnë atë”, ka deklaruar Mavraj.



JOE DHE SHIRLEY DIOGUARDI MARRIN SHTETËSINË E KOSOVËS

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 GUSHT - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, në një ceremoni të veçantë ua ka dorëzuar të hënën dekretin e shtetësisë së Kosovës, Joe DioGuardit dhe Shirley Cloyes DioGuardit.

Në fjalën e saj, Haxhiu, tha se Kosova është shtet i ri, por para se të ishte shtet dhe para se ta fitonte lirinë kishte njerëz që i dolën zot, ndaj ne e kemi për detyrë të mos harrojmë kush janë ata njerëz. “Joseph dhe Shirley DioGuardi janë ndër ata miq që Kosova i pati pranë para se emri i saj të zinte vend në agjendën e politikës amerikane. Përkushtimi juaj ndaj çështjes shqiptare kishte pas vetes një trashëgimi shumë më të vjetër se jeta juaj politike. Ajo vinte nga familja juaj arbëreshe, nga Greci i Italisë, prej një bashkësie që, shekuj pasi ishte shkëputur nga trojet e të parëve, vazhdonte ta ruante shqipen, kujtesën e prejardhjes dhe lidhjen me botën shqiptare. Babai juaj ishte pesëmbëdhjetë vjeç kur u nis nga Greci për në Amerikë. Kur e kthyet në vendlindje në vitin 1974, pas dyzet e pesë vjetësh larg, ai u foli përsëri shqip njerëzve me të cilët kishte kaluar fëmijërinë. Gjuha kishte mbijetuar largësinë, kohën dhe një jetë të tërë në një kontinent tjetër”, u shpreh Haxhiu.

Sipas saj, kjo trashëgimi, që për shumë breza kishte jetuar si kujtesë familjare, te ju mori edhe trajtën e angazhimit politik. “Kur shqiptarët e Amerikës ju folën për Kosovën në mesin e viteve tetëdhjetë, ju ishit një kongresmen i ri, tekta për Kosovën në Uashington dihej fare pak. Në vitin 1986 e ngritët në Kongresin e Shteteve



të Bashkuara çështjen e shkëljes së të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi”, theksoi Haxhiu. Ajo më tej tha se afirmimi i çështjes së Kosovës në Kongresin amerikan në ato vite ishte më tepër se një qëndrim politik. “Duhej të dëshmohej një padrejtësi që pak njerëz e njihnin, të përballohej kundërshtimi i një diplomacie shtetërore që kishte rrënjë e miq të vjetër në Uashington dhe t’u shpjegohej ligjvënësve amerikanë se pas fjalorit zyrtar të Jugosllavisë së asaj kohe qëndronte një popull, të cilit po i cenoheshin vazhdimisht dhe në mënyrën më brutale të drejtat themelore. Ju e nisët këtë punë shumë vjet përpara se represioni sistematik, vrasjet, masakrat dhe dëbimi masiv nga ana e politikës kriminale të Serbisë e shndërruan Kosovën çështje të politikës botërore”, ka pohuar U Haxhiu.

U.d. presidentja Haxhiu, më tej tha se Joe DioGuardi edhe pasi

përfundoi mandatin e tij në Kongres, e vazhdoi angazhimin. “Me themelimin e Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane, në vitin 1989, ajo punë mori një shtrirje tjetër. Ju u kthyet në Kosovë, patë nga afër çfarë po ndodhte, takuat njerëzit që po artikulonin rezistencën politike e intelektuale të shqiptarëve dhe, bashkë me Tom Lantosin, e sfiduat haptas politikën e Slllobodan Millosheviqit në një kohë kur kjo kërkonte edhe guxim personal”, tha ajo.

Më tej, Haxhiu, theksoi se në Uashington, ndërkohë, u krijua një rreth gjithnjë e më i gjerë njerëzish që u njohën me Kosovën dhe ishin të gatshëm të merreshin me të. “Tom Lantos, Bob Dole, Ben Gilman, Claiborne Pell dhe shumë të tjerë u bënë emra që shqiptarët do t’i mësonin e do t’i mbanin përherë në mendje. Në krijimin dhe ushqimin e atyre lidhjeve, Lidhja Shqiptaro-Amerikane dhe ju vetë patët një rol që la

gjurmë në historinë së marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, theksoi Haxhiu.

Ajo theksoi se në ato vite, Kosova nuk kishte ambasadë në Uashington, as diplomaci shtetërore që ta përfaqësonte, duke shtuar më tej se atë zbrazëti e mbushën, sa mundën, mërgata jonë dhe miq si ju, duke ndërtuar lidhje me politikën amerikane, duke sjellë dëshmi nga Kosova dhe duke i hapur çështjes sonë dyer që deri atëherë kishin qenë të mbyllura.

U.d. presidentja Haxhiu tha se Shirley Cloyes DioGuardi iu bashkua kësaj pune nga një rrugë tjetër dhe shumë shpejt u bë një prej zërave më të shquar e më këmbëngulës. “Me përvojën tuaj në botim, shkrim dhe analizë të politikës së jashtme, ju u shndërruat në një kroniste duke dëshmuar, dokumentuar dhe argumentuar për Kosovën, ngase nuk mjaftonte vetëm të

kërkohej mbështetje. Duhej të njëhej historia e saj, të kuptoheshin mekanizmat e represionit, të ndiqej ajo që po ndodhte në terren dhe t’u përgjigjej, me fakte, paraqitjeve që për vite me radhë kishin shtrembëruar, gënjyer e falsifikuar për pozitën e shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Këtë punë e bëtë në shkrime, raporte, dëshmi para Kongresit, takime me politikëbërës e diplomatë dhe në paraqitje të shumta publike”, u shpreh Haxhiu.

Ajo më tej tha se në vitin 2002, të dy shkuan në Hagë për të dëshmuar në procesin kundër Slllobodan Millosheviqit i akuzuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për krime kundër njerëzimit në Kosovë. “Edhe atëherë, si shumë herë më parë, puna juaj ishte dëshmi, pra ju e dëshmoni me fakte atë që Serbia e kishte bërë me vite kundër shqiptarëve të Kosovës. Pas qershorit të vitit 1999, Kosova kishte një betejë tjetër përpara, betejën për ta kthyer lirinë e fituar në një status të qëndrueshëm politik dhe, më pas, në shtetësi. Faleminderit për mbështetjen e madhe që i keni dhënë Kosovës në periudha shumë të vështira!”, theksoi Haxhiu.

Në fund, U Haxhiu tha se për të është nder i veçantë që para pak minutash si ushtruese e detyrës së presidentes pati nderin që t’ua jap DioGuardi dhe znj. DioGuardi shtetësinë e Republikës së Kosovës. “Ju keni qenë miq të Kosovës shumë përpara se ajo të bëhej shtet. Prej sot, jeni edhe qytetarë të saj! Për mua është nder i veçantë t’ju uroj shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe t’ju them: mirë se vini në mesin e qytetarëve të saj. Mirë se vini në shtetin tuaj të dytë, në Republikën e Kosovës!”, tha në fund të fjalës së saj u.d. presidentja Haxhiu.

Vrasja e trefishtë në Glogjan, tre të akuzuarit shpallen të pafajshëm

PRISHTINË, 24 GUSHT - Gjykata Themelore në Pejë ka shpallur të pafajshëm Halil, Kreshnik dhe Kastriot Mehmetajn, të akuzuar për vrasjen e trefishtë në Glogjan. Aktgjykimin u shpall të hënën nga kryetari i trupit gjykues, Leon Përlaska. Kastriot dhe Kreshnik Mehmetaj u liruan nga akuza për veprën penale “Vrasje e rëndë” në bashkëkryerje, kurse

Halil Mehmetaj u lirua nga akuza për veprën penale “Shtytje në vrasje të rëndë”. Kastriot Mehmetaj u lirua nga akuza edhe për armëmbajtje pa leje. “Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues vlerësoi se kjo gjykatë është kompetente dhe se nuk ka nevojë për rihapje të shqyrtimit kryesor andaj duke

vendosur për çështjen që është objekt shqyrtimi turpi gjykues merr vendim njëzëri këtë aktgjykim: të pandehurit Kastriot dhe Kreshnik Mehmetaj lirohen nga akuza për veprën penale “bashkëkryerje, vrasje e rëndë”. I pandehuri Halil Mehmetaj lirohet nga akuza për veprën penale “shtytje në vrasje të rëndë”, ka theksuar gjyqtari Përlaska.



ÇMIMET E PRODHIMIT NË KOSOVË U RRI TËN 4.6% BREND A NJË VITI

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (ICP) për tremujorin e dytë (TM2) 2026. Indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë (ICP) pati një ngritje prej 0,9 % ndërmjet TM2 2026 dhe TM1 2026. Po ashtu, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM2 2026) çmimet e prodhimit u ngritën në një mesatare prej 4,6 %.

Tremujori i dytë 2026 - Tremujori i parë 2026 0,9 %

Çmimet e prodhimit në Kosovë patën një ngritje prej 0,9 % në mes TM2 2026 dhe TM1 2026. Ngritjet më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: prodhimi i pijeve (3,2 %), prodhimi i mjeteve motorike (të



transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (2,6 %), prodhimi i metaleve (2,3 %), prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (2,0 %), energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (1,1 %), veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve (1,0 %), prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (1,0 %), xeherorët dhe guroret

tjera (0,9 %), prodhimi i tekstilit (0,7 %), përpunimi i produkteve ushqimore (0,6 %), prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara –thurëse (0,6 %), prodhimi i produkteve minerale jometalike (0,6 %), prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (0,4 %), prodhimi i mobilie (0,1 %).

Ngritja u neutralizua nga rënia e çmimeve te: prodhimi i veshjeve (-6,4 %), prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (-2,7 %).

Tremujori i dytë 2026 - Tremujori i dytë 2025 4,6 %

Çmimet e Prodhimit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 4,6 %, në mes të TM2 2026 dhe TM2 2025. Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (32,2 %), prodhimi i pijeve (20,1 %), prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (14,7 %), prodhimi tjetër p.k.t (9,8 %), prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (3,8 %), prodhimi i produkteve minerale jo metalike (3,3 %), përpunimi i produkteve ushqimore (3,2 %), prodhimi i mobilie (2,6 %), prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (2,4 %), energjia elektrike, gazi, avulli

dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (2,3 %), prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara –thurëse (2,3 %), prodhimi i pajisjeve elektrike (1,9 %), xeherorët dhe guroret tjera (1,9 %), prodhimi i tekstilit (0,6 %), prodhimi i produkteve kimike (0,6 %), shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara (0,3 %), nxjerrja e xehes së metalit (0,1 %), prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (0,1 %). Ngritja u neutralizua nga ulja e çmimeve te: prodhimi i veshjeve (-6,4 %), prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (-2,8 %), prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-1,6 %), veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve (-1,0 %).

MINTI THOTË SE KA FORCUAR MBIKËQYRJEN E TREGUT: MBI 3 MIJË INSPEKTIVE NË GJYSMËN E PARË TË VITIT 2026

PRISHTINË, 24 GUSHT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) gjatë vitit 2026 ka shënuar progres të rëndësishëm në forcimin e mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, në shkurt të vitit 2026, MINTI i ka kushtuar rëndësi të veçantë rritjes së efikasitetit të inspektimeve, forcimit të kontrollit të tregut dhe adresimit të shpejtë të ankesave të qytetarëve. “Vetëm gjatë pjesës së parë të vitit 2026, Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT) ka realizuar mbi 3,000 inspektive në fusha të ndryshme, përfshirë tregun e derivateve të naftës, sigurinë e

përgjithshme të produkteve, mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit. Po ashtu, janë realizuar mbi 250 inspektive për verifikimin e përmbushjes së kushteve minimale teknike nga operatorët ekonomik. Në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve, gjatë kësaj periudhe janë adresuar mbi 600 ankesa, ndërsa IQMT ka zhvilluar edhe aksione të përbashkëta me Policinë e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës (AMK) dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)”, ka njoftuar MINTI. Sipas kësaj ministrie, efikasiteti i shtuar në mbikëqyrjen e tregut është reflektuar edhe në masat ndëshkuese. “Krahasuar me



periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shqiptimi i gjobave është rritur për 33.33%. Gjatë pjesës së parë të vitit 2026 janë shqiptuar afërsisht 600 mijë euro gjoba për shkelje të ndryshme të evidentuara gjatë inspektimeve, përfshirë mospërputhjen e çmimeve raft-arkë, tregtimin e produkteve pa deklaracion, ushtrimin e veprimtarisë pa regjistrim në ARBK, përdorimin e mjeteve matëse me afat të skaduar të vlefshmërisë, mosrespektimin e afateve të përcaktuara në

procesverbalet e inspektimit, tregtimin e produkteve me afat të skaduar, si dhe vendosjen në treg të produkteve që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi”, ka njoftuar kjo ministri. MINTI ka theksuar tutje se me qëllim të adresimit të problematikave që prekin qytetarët, IQMT ka zhvilluar aksione të veçanta inspektuese në fusha me interes të veçantë publik. Sipas kësaj ministrie, ndër temat e trajtuara kanë qenë çmimet e derivateve të naftës, njehsorët elektrikë, kriptovalutat, veprimtaria e qendrave të masazhit dhe lokaleve të natës, produktet e qumështit, shitja e cigareve elektronike në afërsi të shkollave fillore, parkingjet private të paregjistruara në ARBK, si dhe

çështje të tjera të ngritura nga konsumatorët e Republikës së Kosovës. “Progres është shënuar edhe në rritjen e kapaciteteve të Inspektoratit, ku ka përfunduar faza e parë e transferimit të inspektorëve lokalë të tregut në Inspektoratin Qendror. Ky proces ka krijuar kapacitete më të mëdha për mbikëqyrjen e tregut në nivel vendi, ndërsa deri në fund të vitit 2026 synohet që numri i Inspektorëve të Tregut të arrijë në 100”, theksohet në njoftimin e MINTI-t. Thuhet tutje se këto rezultate dëshmojnë përkushtimin e MINTI-t për një treg më të rregullt, më transparent dhe më të sigurt, si dhe për forcimin e mekanizmave institucionalë në mbrojtje të konsumatorëve dhe interesit publik.

Mbahet ceremonia e betimit të ekspertëve të rinj gjyqësor

Prishtinë, 24 gusht- Në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, është mbajtur ceremonia e betimit të 4 ekspertëve të rinj gjyqësor, të cilët pas përfundimit të procedurës së licencimit, marrin zyrtarisht

përgjegjësinë për ushtrimin e detyrës së tyre profesionale në shërbim të drejtësisë. Me këtë rast, zëvendësministri i Drejtësisë në detyrë, Genc Nimoni, theksoi rëndësinë e rolit të ekspertëve gjyqësor në

proceset gjyqësore, duke nënvizuar se profesionalizmi, integriteti dhe paanshmëria e tyre janë thelbësore për vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në ekspertizë profesionale.

Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë të mbështesë fuqizimin e rolit të ekspertëve gjyqësor dhe integritetin e tyre, me qëllim forcimin e një sistemi të drejtësisë efikas, profesional dhe në shërbim të qytetarëve.



QEVERIA NË DETYRË E KURTIT I DËRGOI VAGONËT E TRENIT PËR RIPARIM NË SERBI

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 GUSHT- Ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka reaguar ndaj lajmit se përfaqësues të ndërmarrjes publike "Trainkos" kanë zhvilluar një vizitë zyrtare në Serbi, në kuadër të procesit për riparimin e vagonëve të trenit. Ministria e Ekonomisë ka paguar 423 mijë euro për rregullimin e tyre. Rizvanolli përmes një postimi në rrjetin social në "Facebook" ka shkruar se vagonët janë dërguar për riparim në Zrenjanin në Serbi për herë të parë në vitin 2017, duke mos e mohuar se edhe qeveria Kurti i ka dërguar vagonët e trenit për riparim në Serbi. "Vagonët janë dërguar për riparim në Zrenjanin në Serbi për herë të parë më 2017, sapo janë blerë, në procedurë të nisur në kohë të Qeverisë Mustafa e të përruruar në kohë të Qeverisë Haradinaj, nga ministri Pal Lekaj. A ka qenë AAK-ja e brengosur për këtë çështje në vitin 2017 kur ministri i tyre e prente shiritin për vagonët e riparuar në Serbi?", ka shkruar Rizvanolli.

Aleanca ka reaguar ndaj deklaratës së Rizvanollit, duke



theksuar se deputetja Rizvanolli, e cila jashtëligjshëm ka uzurpuar postin e ministres, për të cilën do të japë përgjegjësi, po përpiket t'i fshehtë skandalet e saj aktuale të bashkëpunimit

me Serbinë.

Sipas Aleancës, dokumenti që deputetja Rizvanolli ka publikuar në profilin e saj zyrtar i takon datës 17 prill 2017, ndërsa Qeveria Haradinaj është votuar më 9 shtator 2017, plot pesë muaj pas dokumentit të cilit ajo po i referohet. "Në vend që të merret me dështimet dhe bashkëpunimet e saj skandaloze, ministrja duhet t'u përgjigjet qytetarëve se edhe sa punëtorë të tjerë të ndërmarrjeve publike po i kërcënojnë me largim nga puna, vetëm pse po ua shfaqin skandalet dhe po guxojnë të thonë të vërtetën në rrjete sociale, siç është rasti i fundit në Trainkos. Tregojini opinionit se pse edhe sot e kësaj dite, këta ekspertë nga Serbia gjenden dhe operojnë lirshëm brenda hapësirave të Trainkos. Nuk pritet asgjë përpos gënjeshtreve prej njerëzve që ilegalisht i kanë uzurpuar institucionet e shtetit dhe për të cilët, e rithekojmë edhe një herë, se do të japin përgjegjësi", është thënë në reagimin e Aleancës. Edhe analisti Imer Mushkolaj i ka reaguar ministres

Rizvanolli. Ai ka thënë se nëse të tjerët i paskan dërguar më herët vagonët për riparim në Serbi, e pse edhe LV-ja veprë njësoj. "Mirë, nëse i paskan dërguar vagonët për riparim në Serbi ata 'të këqijtë', pse vepruat njësoj ju 'të mirët'? Ju që thoshit se me Serbinë as që do të bisedonit ndonjëherë. Ju që secilin kritik tuajin e keni nxirë duke e cilësuar si 'njeri të Serbisë'", ka shkruar në "Facebook".

Ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Korenica, ka deklaruar se e kishte informuar kryeministrin Albin Kurti lidhur me kontratën për renovimin e vagonëve të "Trainkos"-it në Serbi, por se nuk kishte marrë asnjëherë përgjigje. "E konfirmoj që nuk kam marrë përgjigje asnjëherë nga z. Kurti. Përveç tij kam njoftuar edhe të tjerë, por kanë zgjedhur ta heshtin këtë tender korruptiv që ka cenuar edhe sigurinë publike", ka deklaruar Korenica për "Telegraf"-in.

Deputetja e zgjedhur e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka reaguar pasi ish-deputeti i LV-së, Visar Korenica, ka konfirmuar se e kishte

njoftuar Kurtin qysh në vitin 2024 për tenderin për dërgimin e vagonëve për riparim në Serbi. "Albin Kurti paska qenë i informuar qysh më 24 maj 2024 për kontratën e Trainkos-it për renovimin e vagonëve në Serbi. I paralajmëruar. I informuar. Në dijeni. Dhe ka heshtur. Sot ndëshkohet punëtori që flet, ndërsa askush nuk jep përgjegjësi për ata që e kanë ditur dhe e kanë lejuar", ka shkruar Deliu-Kodra në "Facebook".

Edhe deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, ka reaguar lidhur me vizitat e zyrtarëve në Serbi, duke kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që të ndërmarrë veprime. Ramadani përmes një postimi në "Facebook", ka pretenduar se zyrtarë të lidhur me Qeverinë e Kosovës kanë vizituar Serbinë në vitin 2024, pas sulmit terrorist në Banjskë më 24 shtator 2023.

Ndërkaq, zyrtari i Aleancës, Daut Haradinaj, kishte thënë se përfaqësues të ndërmarrjes publike "Trainkos" zhvilluan një vizitë zyrtare në Serbi, në kuadër të procesit për riparimin e vagonëve të trenit.



Pacolli e Lushtaku nënshkruajnë marrëveshjen për financimin e programeve të banimit

SKENDERAJ, 24 GUSHT - Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, ka njoftuar se është nënshkruar marrëveshja për financimin e Objektivit Ç, në kuadër të Programit të Banimit Social Adekuat. Marrëveshja është nënshkruar me ministren në detyrë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli, ndërsa vlera e projektit kap shumë prej 4.4 milionë eurosh. Sipas

Lushtakut, financimi është siguruar përmes kredisë nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës. Objekti Ç do të jetë i dedikuar me prioritet për familjet e dëshmorëve të Komunës së Skenderajt, me qëllim, siç ka theksuar Lushtaku, përbushjen e një obligimi institucional dhe moral ndaj familjeve që kanë dhënë kontributin e tyre për lirinë

e Kosovës. "Pas Objektivit U, edhe Objekti Ç po bëhet realitet!", ka shkruar Lushtaku.

Ai ka bërë të ditur se synimi i radhës është realizimi i Objektivit K, me të cilin do të kompletohej tërësisht kompleksi UÇK. Lushtaku ka theksuar se Komuna do të vazhdojë punën për realizimin e këtij projekti, duke e cilësuar atë si një tjetër zotim ndaj familjeve të dëshmorëve.



NGA THATËSIRA TE PËRMBYTJET: SI PO NDRYSHON KLIMA DHE ÇFARË DO TË THOTË PËR BUJQËSINË E KOSOVËS

PRISHTINË, 24 GUSHT - Temperaturat mesatare në Kosovë janë rritur gjatë dekadës së fundit, ndërsa fermerët po përballen me periudha më të gjata të thatësisë, valë të të nxehtit dhe reshje të shkurtra, por intensive. Ndryshimet në temperaturë dhe në shpërndarjen e reshjeve po e bëjnë prodhimin bujqësor gjithnjë e më të paparashikueshëm. Ekspertët thonë se fermerët dhe institucionet duhet të përshtaten me këto ndryshime, nga përzgjedhja e kulturave dhe varieteteve deri te mënyra dhe koha e mbjelljes. Për fermerët, ndryshimi i klimës nuk është vetëm çështje statistikash. Pasojat shihen drejtpërdrejt në ara dhe në të ardhurat e tyre.

“Puna e tre muajve u zhduk për gjysmë ore”

Ilvi Jupa, 64-vjeçar, bujk nga Komuna e Rahovecit, kishte mbjellë rreth gjysmë hektari me pjepër, në fshatin Bërnjak. Stuhia dhe erërat e forta që nisën në këtë rajon më 21 korrik, si dhe reshjet e dendura të mëngjesit të 27 korrikut, ia përmbytën parcelën dhe ia shkatërruan të gjithë prodhimin. “Tre muaj, i kemi shikuar për çdo ditë, se a po rriten [pjeprat], a po zhvillohen... Kur u bënë gati, për një gjysmë ore uji e fshiu krejt”, tregon Jupa për Radion Evropa e Lirë. “Ky produkt ka shkuar dëm, është prishur. Janë kalbur nga poshtë, të gjithë. Tash, asgjë... vera është e humbur”, thotë ai. Jupa tregon se vetëm në parcelën me pjepër kishte investuar rreth 4.000 euro dhe synonte të fitonte rreth 7.000 euro. Për të zburur humbjet, ai po përpiqet të shesë në mënyrë ambulante shalqirin që kishte mbjellë në një parcelë tjetër, e cila nuk u prek nga përmbytjet. Por, edhe ky prodhim u dëmtua pjesërisht nga temperaturat e larta gjatë korrikut. Sipas Jupës, thatësia e shkaktuar nga temperaturat e larta, por edhe reshjet që vijnë me intensitet të madh, janë bërë më të shpeshta gjatë katër-pesë vjetëve të fundit. Ai thotë se në tre vjetët e fundit prodhimet bujqësore i janë dëmtuar vazhdimisht. “Klima po ndikon. Tash është më thatësirë. Por, kur bie shi, bie me më shumë hov, dhe i përfshin uji më shumë. Më parë, kurrë nuk e ka përfshirë uji kështu”, thekson Jupa, i cili gjatë gjithë jetës është marrë me kultivimin e produkteve bujqësore.

Dëmet në Rahovec

Autoritetet lokale të Komunës së Rahovecit thonë se dëmet e evidentuara nga kushtet klimatike gjatë vitit 2026 kanë qenë të mëdha. Behar Thaqi, drejtues i Drejtorisë për Bujqësi në këtë komunë, thotë se që nga fillimi i janarit, reshjet e shumta kanë përmbysur arat e fermerëve dhe kanë dëmtuar të mbjellat. Specat, shalqiri, pjepri dhe rrushi, që ishin në fazën e pjekjes, në shumë hektarë u shkatërruan nga përmbytjet, sipas tij. Dëmet e

shkaktuara ende janë duke u përlogaritur nga komisionet komunale. “Sipas vlerësimit të komisionit komunal, kanë qenë rreth 167 mijë euro, vetëm te fermerët”, pohon Thaqi për Radion Evropa e Lirë. Erërat e forta të 21 korrikut dëmtuan dhjetëra hektarë vreshta. “Ka pasur vreshta të kultivuara tash e 40 vjet. Janë rrëzuar”, thotë Thaqi, duke treguar se dëmet u shtuan edhe më 27 korrik, pas reshjeve të dendura dhe me intensitet të madh. Sipas tij, ndikimi i ndryshimeve klimatike po bëhet gjithnjë e më i dukshëm dhe, nëse fermerët nuk marrin ndihmë dhe udhëzime nga shteti, mund të ndryshojë edhe struktura e kulturave që kultivohen në këtë komunë. “Atëherë do të ndryshojë harta e kulturave bujqësore në Rahovec”, thotë ai. Ndryshimi i temperaturave, reshjeve dhe periudhave të vegjetacionit mund të ndikojë në përshtatshmërinë e kulturave në zona të caktuara të Kosovës. Temperaturat shumë të ulëta në pranverë, temperaturat e larta dhe thatësira gjatë verës, si dhe reshjet e dendura, në vitet e fundit kanë shkaktuar dëme në zona të ndryshme të Kosovës.

Temperaturat po rriten

Matjet nga viti 2016 deri më 2025 në gjashtë stacione meteorologjike – Ferizaj, Mitrovicë e Jugut, Prishtinë, Junik, Prizren dhe Pejë – tregojnë një rritje mesatare të temperaturës prej 0.55 gradë Celsius. Sipas Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), temperatura mesatare vjetore në Kosovë ishte 11.87 gradë Celsius në vitin 2016, ndërsa në vitin 2025 ishte 12.42 gradë. Brenda kësaj dekade, viti më i ftohtë ishte 2016, ndërsa më i ngrohti ishte 2024, me temperaturë mesatare prej 13.18 gradë. Besim Aliu, zyrtar për meteorologjinë në IHMK, thotë për Radion Evropa e Lirë se matjet në gjashtë stacionet meteorologjike tregojnë rritje të ndryshme në rajone të ndryshme të Kosovës. Sipas tij, gjatë kësaj dekade temperatura mesatare është rritur për 1.06 gradë në Ferizaj, 0.90 gradë në Mitrovicën e Jugut dhe 0.89 gradë në Prishtinë. Në Junik, Prizren dhe Pejë janë shënuar “rritje më të vogla dhe jo statistikisht të sigurta, për shkak se variojnë vit për vit”. “Në përgjithësi, mesatarja ka lëvizur diku midis gjysmë grade dhe një gradë brenda kësaj dekade. Kjo është në linjë me atë që vërehet edhe në rajonin e Ballkanit, dhe në Evropën Juglindore në përgjithësi”, thekson Aliu. Sipas tij, vitet shumë të ngrohta janë bërë më të shpeshta – 2023, 2024 dhe 2025 – ndërsa është rritur edhe numri i ditëve me temperaturat mbi 35 gradë dhe i netëve tropikale. Si shembull, ai merr matjet në Klinë dhe Han të Elezit. “Temperatura maksimale e regjistruar ka shkuar nga 37.6 gradë në vitin 2015, në 40.5 gradë, përkatësisht 42.4 gradë në vitin 2025. Kjo është një shenjë e qartë e



rritjes së ditëve e valëve të vapës ekstreme”, thekson Aliu. Sipas tij, sezoni i ditëve të nxehta tashmë fillon më herët dhe zgjat më shumë sesa një dekadë më parë. Megjithatë, Aliu thekson se një dekadë është periudhë e shkurtër për të përcaktuar klimën në kuptimin shkencor, pasi Organizata Botërore e Meteorologjisë përdor norma 30-vjeçare. Por, sipas tij, sinjalet e rritjes së temperaturave janë të qarta. Nëse trendi vazhdon me të njëjtin ritëm, “brenda 20 - 30 vjetëve të ardhshëm Kosova mund të përjetojë rritje mesatare të temperaturës prej 1.5 deri në 2 gradë, krahasuar me periudhën 2015 - 2018”. Për reshjet, megjithatë, të dhënat e dekadës së fundit nuk japin një trend afatgjatë statistikisht të sigurt, pasi ato ndryshojnë ndjeshëm nga viti në vit. Viti 2025 shënoi kushte dukshëm më të thata, veçanërisht gjatë verës. Megjithatë, sipas Aliut, “vërehet një shpërndarje gjithnjë e më e pabarabartë e reshjeve, me periudha të gjata pa reshje të ndërpreura nga episode të shkurtra me intensitet të lartë”.

Ndikimi në bujqësi

Në Rahovec, Thaqi vlerëson se ndikimi i rritjes së temperaturave në bujqësi është i pashmangshëm. Një nga pasojat mund të jetë ndryshimi i periudhave të vegjetacionit. “Fillimi më i hershëm i pranverës mund të zgjasë sezonin e mbjelljes, por rrit edhe rrezikun e ngricave të vona, kur bimët lulëzojnë më herët, por ngrica ende mund të vijë”, thotë ai. Gjatë verës, sipas tij, mund të shfaqet “stresi termik”, me valë vape që janë të rrezikshme për kulturat e ndjeshme, si misri, perimet dhe pemët frutore, veçanërisht gjatë fazave kritike të lulëzimit dhe mbushjes së kokrrës. Në prill të këtij viti, në Prishtinë, u mbloodhën agjencitë dhe ekspertët e Kombeve të Bashkuara, bashkë me përfaqësues të organizatave joqeveritare vendëse dhe ndërkombëtare, për të analizuar rreziqet aktuale dhe të parashikuara klimatike që ndikojnë në bujqësi. Në një raport të publikuar nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO) në maj, thuhet se ndikimet klimatike në Kosovë shihen përmes rënies së rendimenteve të të korrave, rritjes së stresit mbi bagëtinë dhe dëmtimit të të korrave dhe infrastrukturës nga ngjarjet më të shpeshta dhe intensive klimatike. Imer Rusinovci, profesor i bujqësisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se ndryshimet klimatike dhe moti i paparashikueshëm po prekin si kulturat e mbjella në

vjeshtë, ashtu edhe ato të mbjella në pranverë. “Gjithmonë i kemi në rrezik kulturat bujqësore, që mbillen në vjeshtë, nga reshjet intensive dhe vërshimet e papritura. Edhe kulturat pranverore po ashtu sulmohen, posaçërisht nga thatësia e madhe”, tregon Rusinovci për Radion Evropa e Lirë. Kulturat që mbillen në vjeshtë përfshijnë grurin, elbin, thekrën, tërshërën dhe përzierjet foragjere, ndërsa në pranverë mbillen misri, patatja, fasulja, luledielli, soja dhe shumica e perimeve, si specat, domatet e trangujt, si dhe shalqiri, pjepri e kungulli. Sipas Rusinovcit, fermerët duhet t’i përshtatin kulturat dhe varietetet me kushtet klimatike dhe lartësinë mbidetare. Në lartësitë mbi 700 metra mbi nivelin e detit, temperaturat janë më të ulëta dhe vegjetacioni i të mbjellave mund të vonohet për rreth një muaj, ndërsa në rajonet më të ulëta rritet rreziku nga thatësira. “Duhet të rekomandoohen hibridet që janë më të hershme, dhe që kanë periudhë vegjetative më të shkurtër [në lartësitë mbidetare mbi 700 metra]. Ndërkaq, në rrethanat e thatësisë [në rajonet më të ulëta], duhet rekomanduar hibridet që janë më të rezistueshme”, thotë ai. Lartësia mesatare mbidetare e Kosovës, sipas të dhënave që përdor Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, është rreth 800 metra. Pika më e ulët është rreth 300 metra, ndërsa më e larta 2.656 metra. Ndryshimet në temperaturë dhe mot mund të ndikojnë edhe në kalendarin e mbjelljeve dhe korrjeve. “Për shembull, afati optimal agroteknik i mbjelljes së grurit në Kosovë është tetori. Nëse ka paralajmërim se ka çrregullime moti, thatësi... mbjellja mund të bëhet deri më 10 nëntor. Por, te mbjelljet e vonuara, për shkak të ndryshimeve klimatike, duhet shtuar 5 deri 10 për qind repromaterial [fare dhe pleh] më shumë se zakonisht”, sqaron ai. Rusinovci thotë se fermerëve duhet t’u ofrohet një strukturë më e llojllojshme e kulturave bujqësore. “Ato që janë më rezistente ndaj luhatjes së temperaturave duhet t’i avancojmë, ndërkaq ato që nuk janë t’i eliminojmë”, thekson ai.

Përshtatja po bëhet e domosdoshme

AgroDev, organizatë që merret me zhvillimin e bujqësisë në Kosovë, vlerëson se diversifikimi i kulturave është i domosdoshëm dhe se ky proces tashmë ka nisur. Drejtori i përgjithshëm i saj, Fatmir Selimi, thotë se në Kosovë vazhdon të kultivohen kulturat tradicionale, si gruri, misri, mollët, kumbullat, speci, domatja dhe të tjera. Sipas tij, varietetet e reja të tyre kanë rritur rendimentin. Por, ndryshimet klimatike kanë bërë që të provohen edhe kultura që disa dekada më parë nuk janë kultivuar në Kosovë. “Për shkak të ndryshimeve klimatike, dikush

mund t’i nxjerrë dy të korrura. Kemi provuar tash kultura të reja, si mjedra, boronica, shafrani, varietete të ndryshme të sallatave, si dhe ushqime të tjera, që fermerët po i kultivojnë edhe me serra. Aty po arrijnë rendimente të kënaqshme”, tregon Selimi për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, fermerët nuk duhet vetëm të shqetësohen për ndryshimet klimatike, por të përgatiten për to. “Duhet të përgatitemi dhe të ballafaqohemi me këto ndryshime klimatike. Së pari, duhet të dimë vet të ballafaqohemi, e pastaj t’i drejtohem shtetit për ndihma. Roli ynë, si ekspertë, është që t’u tregojmë fermerëve se cilat janë praktikat më të mira për t’u përshtatur kushteve klimatike”, thotë Selimi. Ai kujton raste kur fermerët kanë hezituar të mbjellin kultura të reja. “Për shembull, nga 80 kultura bujqësore që kanë potencial të zhvillohen në Kosovë, në Rahovec ne planifikonim kultivimin e kivit. Ka shumë potencial që të bëhet në pjesën jugore të Kosovës - në Rahovec, Suharekë e Prizren. Por, nuk kemi gjetur njerëz që ta bëjnë kultivimin e tij”, thotë Selimi. Sipas tij, institucionet përgjegjëse dhe organizatat që promovojnë bujqësinë e qëndrueshme duhet t’u ofrojnë fermerëve pilot-projekte, përmes të cilave ata mund të shohin në praktikë nëse kultura të caktuara mund të jenë të leverdishme. “Kur të shohin se kanë sukses, atëherë i nxit fermerët që t’i kultivojnë ato kultura, dhe t’u përshtaten kushteve klimatike”, thotë Selimi. Megjithatë, për t’u përballur me ndryshimet e mundshme në strukturën e kulturave bujqësore, sipas tij, nevojitet një “strategji e mirëfilltë” nga institucionet qeveritare. Selimi i sheh si të pamjaftueshme dhe joadekuate dokumentet aktuale të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përfshirë Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022–2028, në të cilën është përfshirë edhe përshtatja e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike. Ministria nuk i është përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë për objektivat konkrete që synohen në dhjetëvjeçarin e ardhshëm në raport me ndryshimet klimatike, për buxhetin aktual të dedikuar për përshtatjen ndaj tyre, si dhe për ndryshimin e mundshëm të hartës dhe strukturës së kulturave bujqësore në vend. Kjo lë të hapur një nga pyetjet kryesore për bujqësinë e Kosovës: ndërsa fermerët tashmë po përballen me ndryshime në temperaturë, thatësira dhe episode të reshjeve intensive, sa të përgatitura janë institucionet për t’i ndihmuar ata të përshtaten? Për bujkun Jupa, përgjigjja është ende e pasigurt. Javë pasi reshjet e rërmyeshme ia shkatërruan prodhimin, ai thotë se nuk do të mbjellë më pjepër. “Tjetër gjë këtu nuk bëhet. Nuk guxoj më të mbjell këtu, sepse uji po m’i prish. Asgjë, vetëm ta lë si lëndinë”, thotë ai. “Me çka të jetoj? Zoti e bëftë zgjidhjen”, shprehet Jupa.

FAIK KONICA: ARMIQT E SHQIPËRISË (DO TË NGORDHIN PËR BUKË)

Ka tekste që i përkasin kohës kur janë shkruar dhe ka të tjera që, sado vite të kalojnë, vazhdojnë të tingëllojnë çuditërisht aktuale. Ky shkrim nga Faik Konica, botuar në revistën “Albania” në qershor të vitit 1897, i përket padyshim të dytëve.

Me gjuhën e tij therëse, ironinë pa mëshirë dhe atë aftësi të rrallë për t’i kthyer dobësitë tona kolektive në një pasqyrë të pamëshirshme, Konica ngre një pyetje që do ta shoqëronte mendimin e tij gjatë gjithë jetës: cilët janë në të vërtetë armiqtë e Shqipërisë?

Përgjigjja e tij është brutale: jo gjithmonë duhen kërkuar jashtë kufijve. Për Konicën, rreziku më i madh vjen nga përcarja, servilizmi, shitja e interesit të përbashkët për përfitimin personal dhe nga paaftësia për ta vendosur Shqipërinë mbi ndasitë fetare, gjuhësore e interesat e çastit.

Duhet lexuar, natyrisht, si një tekst i vitit 1897, me fjalorin, zemërimin dhe rrethanat politike të asaj kohe. Por, 129 vjet më vonë, disa prej pyetjeve që ngre Konica mbeten çuditërisht të njohura.

Pikërisht për këtë arsye ia vlen ta lexojmë e rilexojmë.

Armiqt e Shqipërisë


FAIK KONICA

“Albania” (1897)

Të gjithë ata që kanë njohur mire vëndin tonë, shkrojnë që dheu i Shqipërisë munt të japë bukë njëzet milion shpirtëve: e dini që jemi tre milionë edhe që dy milionë prej nesh ngordhin urije; shkrojnë që Shqipëtarët janë mjaft të mënçurë me punuëm, nukë vetëm për zbulurimin e tyre, por edhe për mirësin’ edhe për dritën e gjithë njerëzisë: e dini mirë që Shqipëtarët të mësuarë janë më të rallë se fjala të verteta në gojë prifti. Cilët prejtin bukën e barkut, cilët prejtin bukën e mëndes?

Kemi armiq. Për atë, të gjithë bashkohen në një zë. Vetëm për këtë ndahen që të gjithë nukë tregojnë një armik. Ca zgjatin gjishtin drejt dhëpëris’ e Grekut, ca dëftojnë gjarpërimitin e Shevet, ca të jerë emërojnë, me zë të unjtë, trashërin’ e Halldupëve.

Kur dëgjojmë të tilla, neve na vjen një i pambajtur gas. Armiqt’ e Shqipërisë janë Shqipëtarët, jo të tjerë. Shqipëtarët kanë shkruar me gjakn’ e tyre më tepër se një faqe në histori të Evropës. Nga më të vogëlat të trazuarat gjer në luftat më të gjaktat, Shqipëtarë ka hequr hark, vetëtitur kordh a zbrasur pushkë. A ka gjë më të turpëshme, më të unjtë se historia e këtij kombit që – për pakë të qelbur ergjënt – shet



mish njeriu në ç’do luftë, edhe kujt s’i erdhi dëshërim, nga aqë qint vjet që e shkelin edhe e kurvërojnë të huajtë, s’i erdhi dëshërim të japë dy pika gjak për lirin’ e veteheesë? Të dojin Shqipëtarët lirin’ e Shqipërisë, lehtazi e bëjin; po rinë të patundurë, edhe andej dëftojnë që s’e duan Shqipërinë, dëftojnë që janë armiqt’ e saj.

Dëgjoni mirë, në mos e dini: S’janë armiq vetëm duke ndenjtur duart në gjë po ditë për ditë edhe ndryshe punojnë kundërë mëmëdheut. Sa të fëlliqua shkrohen në Greqi, a tjetërkund, kundërë të mjerëve Shqipëtarëve, kundërë Paloarvanitëve, sa kanune linden në Stamboll për të therur Shqipërinë (Pis-Arnautluk), të tera Shqipëtarët i nxjerin.

Shkaku i këtyre të ligave është se Shqipëtarët s’kanë shpirtin miaft të lartë për të dashur lirinë; Shqipëtarët psherëtitin nat’ e ditë pas orës tek do të mundin të jenë fare fare robër nënë Turkun a nënë Grekun, të hidhen në gjunjë përpara Gjorgos, t’i qërojnë thonjtë me gjuhe. Veç zakones, që ryri në gjak të Shqipëtarëve, të veshin gjithënjë lëkurën e Turkut, e Grekut a nonji tjetërit zotit, është dhe shkaku i gjuhëve e i besave.

Ata prej nesh që s’ e kuvendojnë shqipen, arisin lehtazi të besojnë që s’janë Shqipëtarë. Ç’ka të bëjë gjuha në këtë punë? Helvecianët,

për tregim, kuvëdojnë ca frëngjishten, ca gjermanishten: po janë një komb. Pse? Se kanë një rrëzë, edhe kombi është punë rrëze, jo gjuhe.

Tjetëri shkaku është që ca prej Shqipëtarët janë të sunetisur, ca te pagëzuarë. Këto të dy punërat miaft për të qeshur janë, edhe – në qoftë që nonji këndonjës nuk i njeh – ja, shkurt, qysh bëhen. Kur aritet një djale shtat a tet vjeçar, i at’ i tij fton miqtë, han’ e pinë dhe këndonj; pastaj, duke rënë vjollitë, një maskara i qaset të gjerës foshnjës – e cila ulërin dhe përpiqet – edhe me një gërshërë në dorë i pret një thellë mish të një vent që është turp ta emëronj. Janë Shqiptarë që s’e bëjnë këtë punën; por ata, kur lindet një djale, ja shpien një prifti mjekërqelburi, i cili e mer edhe e klet lakuriq brënda në një magje plot me ujë.

Mos e mirni shtrembër mendimin tim, u lutem; une s’kuvendonj kundërë këtyrave punërave: të mira a të liga, ç’do njeri është i lir t’i besojë edhe t’i mbajë.

Vetëm një pjetje ju kam për të kërkuar, duke falur nderjes: A kuptoni si mund t’i ndrohet rrëza një njeriut sepse – kur që djale – i keputnë një cope mish a e vunë brënda në një magje? Mua s’m’a pret mendia.

Na mbeti pakë vent, pakë na mbeti dhe koh. Andaj nukë mundim këtu të qajmë, me

mëmëdhetarët e vërtetë, të këqijat tona. E gjerë Shiperi! Dhe në mes të dashurve djemëve tënd, gjeti rrugë të hyjë shpirtunjturia e armiqëve! Miaft gjak kemi në zëmbërë, edhe miaft të çuditëshma ato që na vijnë nga Bukureshti. Po me mos ditur akoma në janë fare të vërteta, nukë na e jep shpirti të bëjmë fjalë.

Kemi shpresë se ata që na ndeznë e na dhanë zëmbërë të nisim luftën, nukë do t’na dalin të pabesë. Qofshin të diturë, qofshin të paditurë, – nukë janë djem, po njerëz të pjekurë, dhe miaft çudi është në mos kuptojnë dhokanin që ju ngrehin armiqtë, miaft çudi në mos kuptojnë mirësinë që neve ëndërojmë për ata!

Si do që të jetë, mëmëdhedashuria na bën detyrë të përpiqemi t’u lidhim gojën armiqëve. Armiqë gjejtin kundërë neve shkaku që ngajtjmë punën e besave. Armiqë ngorthçin! Këtej e tutje, e përkohëshmia lëshon mb’anë Perëndinë, shentët, ungjillët, kishërat, xhamirat, priftëritë dhe oxhallarëtë tok! Sa kishim bërë gati, i prishmë, që të ecijmë mbas udhës së re.

Të shohim ç’baltë kanë për të ngrënë armiqtë!

Më të mëdhenjt armiqt’ e

Shqipërisë – e thamë – janë Shqipëtarët. Spiunët që paguan Halldupi, spiunët që paguan Greku, spiunët që paguan Shqau, nukë janë Halldupë, nukë Grekë, nukë Shqenj – janë Shqipëtarë. Duhet më pak ergjënt për të blerë një shakull djathë se për të blerë vetëdijen e këtyre kafshëve cilët – me punët që bëjnë, – e fëlliqin emërin Shqipëtar. Prej këtyre faqezinjve le të marrim sot ata që punojnë për Halldupin, Turkomanët, edhe le t’u themi dy fjalë: Juve s’kini mënde që të kuptoni ç’është mëmëdheut, s’kini shpirt që të ndjeni bukurirat e Shqipërisë, s’kini zëmbërë që t’u vijë keq për sa vuajnë të mjerët Shqipëtarë, – po kini barkun miaft të gjërë dhe u ka ënda për të ngrënë nat’ e ditë:

Andaj u pyes, ku kini për të gjetur bukë kur të ngjallet – SE KA PËR TË NGJALLUR – Shqipëria? Sa kini, sa nukë kini, statë Shqipëtar ju a ka për të rrëmbyer në emër të kombit; do të jini të ndjekurë si ligëtarë, dhe Halldupi – me mos patur nevojë prej jush – do t’u lëshojë pa bukë. Juve që sot rroni me pagimet e tradhësisë, ahëre do të lipni po nukë do t’u japin, do te bini më dhë, e do të ngordhni urie. Ashtu qoftë! Qershor 1897

UKRAINA KËRKON NDIHMËN E ELON MUSK PËR DRONËT

Starlink e Elon Musk mund të përdoret për të goditur
objektiva raketorë brenda Rusisë



Ukraina po kërkon miratimin për të përdorur dronë të pajisur me Starlink kundër lëshuesve të raketave balistike brenda Rusisë, në një rreze deri në 200 kilometra nga kufiri. Kërkesa vjen në një moment kur Kiev po përballet me mungesë serioze të raketave interceptuese për mbrojtjen ajrore, sipas personave të njohur me çështjen. Një operacion i tillë do të kërkonte miratimin e Elon Musk, qëndrimi i të cilit ndaj Ukrainës dhe përdorimit të rrjetit të tij satelitor në luftë ka ndryshuar në periudha të ndryshme. Një pengesë tjetër për Kievin është se zyrtari që kishte një linjë të drejtpërdrejtë komunikimi me miliarderin amerikan të teknologjisë, ish-ministri ukrainas i Mbrojtjes Mykhailo Fedorov, është shkarkuar së fundmi.

Ukraina po përballet me mungesë të raketave Patriot

Kërkesa e Ukrainës vjen ndërsa

vendi po përpiqet t'i bëjë ballë intensifikimit të sulmeve ruse me raketa dhe dronë, në një kohë kur rezervat e interceptorëve Patriot po pakësohen. Presidenti Volodymyr Zelensky u ka kërkuar Shteteve të Bashkuara, presidentit Donald Trump dhe partnerëve të tjerë të Ukrainës që të sigurojnë më shumë interceptorë. Por përdorimi i tyre edhe në Lindjen e Mesme, përfshirë gjatë luftës së SHBA-së me Iranin, e ka thelluar mungesën globale të raketave interceptuese të prodhimit amerikan. Edhe në skenarin më të favorshëm, sipas Franz-Stefan Gady, analist ushtarak me bazë në Vjenë, Ukraina nuk ka gjasa të marrë në kohë një numër të mjaftueshëm interceptorësh për të ruajtur strategjinë aktuale të mbrojtjes ajrore. Ai e përshkruan situatën si një përpjekje për të "rëzuar raketat balistike që po afrohen". Rusia ndërkohë ka rritur prodhimin e raketave dhe dronëve, duke bërë që Ukrainës t'i nevojiten qindra interceptorë Patriot deri në fund të vitit.

Elon Musk dhe Starlink, nga mbrojtja te goditja e burimit të sulmit

Përballë këtij kufizimi, Kiev po kërkon një strategji tjetër: në vend që të përpiqet vetëm të rëzojë raketat pasi ato janë lëshuar, Ukraina dëshiron të godasë sistemet që mundësojnë sulmet përpara se ato të ndodhin. "Si mund të angazhohet Ukraina në një strategji më proaktive, duke goditur harkëtarin dhe jo shigjetën?", pyet Gady. Me këtë ai i referohet përpjekjes për të shkatërruar lëshuesit e raketave, sistemet e komandimit, logjistikën dhe asetet e tjera që mundësojnë sulmet ruse. Pikërisht këtu hyn në lojë Starlink.

Pse Starlink mund të ndryshojë aftësitë e dronëve ukrainas

Dronët e pajisur me Starlink përdorin rrjetin satelitor të SpaceX për të ruajtur lidhje më të forta me operatorët në distanca më të mëdha sesa lejojnë sistemet konvencionale të komunikimit me

radio. Njëkohësisht, kjo i bën ata më pak të goditshëm nga metodat e zakonshme të bllokimit elektronik. Dronë të tillë kanë rezultuar tashmë efektivë në fushën e betejës brenda Ukrainës. Nëse përdorimi i tyre do të lejohej edhe përtej kufirit, sipas Gady, ata "mund të ishin shumë të dobishëm për të gjuajtur" lëshuesit rusë të raketave.

Zelensky ia kërkoj Trumpit. Por vendimi mund të jetë i Musk

Zelensky ia paraqiti këtë çështje Donald Trump gjatë takimit të tyre në Shtëpinë e Bardhë në korrik, duke i kërkuar presidentit amerikan të fliste me Musk për sigurimin e lejes që Ukraina të përdorte Starlink përtej kufijve të saj. Por Trump nuk u duk mbështetës i planit, sipas dy personave të pranishëm në takim. Ata thanë gjithashtu se besonin se Musk nuk do t'ia jepte Kievin miratimin e nevojshëm. Vetë Elon Musk nuk ishte i disponueshëm për koment.

Marrëdhënia e ndërlikuar e Elon Musk me luftën në Ukrainë

Miliarderi i teknologjisë ka mbështetur përdorimin e gjerë të Starlink nga Ukraina për komunikim dhe mbrojtje. Shërbimi satelitor i internetit i SpaceX është jetik për sistemet e komandimit dhe kontrollit të ushtrisë ukrainase, si edhe për sistemet ajrore, detare dhe tokësore pa pilot që po transformojnë mënyrën se si zhvillohet lufta. Por Musk ka vendosur edhe kufizime për mënyrën se si Ukraina mund ta përdorë teknologjinë e tij. Në shkurt, pas një kërkesë të drejtpërdrejtë nga Fedorov, atëherë ministër ukrainas i Mbrojtjes, Musk bllokoi përdorimin e paautorizuar të Starlink nga ushtria ruse kundër Ukrainës. Tani Kiev kërkon diçka shumë më të ndjeshme: të përdorë të njëjtën teknologji për të çuar dronët ukrainas përtej kufirit dhe për të goditur drejtpërdrejt infrastrukturën ushtarake ruse. Burimi: Financial Times / bota.al




SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82



Hidhet shorti për Superligën e Kosovës në futsall, gara nis më 5 shtator

PRISHTINË, 24 GUSHT - Është hedhur shorti për edicionin e ri të Superligës së Kosovës në futsall, ku na pret një garë e fortë dhe plot emocione në

sezonin 2026/27. Dhjetë ekipe do të luftojnë për objektivat e tyre, duke sjellë një kampionat interesant dhe konkurrues, ashtu siç ka ndodhur edhe në

sezonet e fundit. Superliga e Kosovës në futsall do të startojë më 5 shtator, ndërsa klubet tashmë kanë mësuar orarin e ndeshjeve për

edicionin e ri. Komisioni i Futsallit u ka uruar suksese të gjitha klubeve pjesëmarrëse dhe arritjen e objektivave të tyre në sezonin 2026/27.

NDESHJET SUPERLIGA	
SEZONI	KLUBET
2026/27	1. Fushë Kosovë, 2. Prishtina, 3. Ballkani, 4. Drenica, 5. Ferizaj, 6. Prizren, 7. Gjakovë, 8. Tërnoc, 9. Vushtrria, 10. Llapë

KOSOVA MPOSHT ME PËRMBYSJE MALIN E ZI NË PADEL

TARANTO, 24 GUSHT - Ekipi i Kosovës në padel, në konkurrencën e përzier "Mixed Doubles", ka mposhtur Malin e Zi në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026". Dyshja Lavdrim Krasniqi dhe Donika Bashota ka triumfuar ndaj çiftit malazias Gianluca

Pelonzi dhe Ivanka Simonoviq, me rezultat 6-7, 6-4, 6-1. Me këtë fitore, Kosova ka siguruar kualifikimin në çerekfinale në dy kategori, ndërsa në ndeshjen e radhës do të përballlet me çiftin italian Casetta dhe Dal Pozzo.



ADEMI: FODA REFUZOI MILIONAT PËR TË QËNDRUAR NË KOSOVË

PRISHTINË, 24 GUSHT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka folur për trajnerin e Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, dhe bindjen e tij për të vazhduar me "Dardanët". Në emisionin "Sport Show" në "Klan Kosova", Ademi ka thënë se Foda është i fokusuar të lërë gjurmë në karrierën e tij, duke theksuar se, sipas kreut të FFK-së, Foda ka lënë histori

në Kosovë. "Ka ardhur në fazën më të mirë, gati në fazën e pranimit, Foda. E thashë që projektin tonë të përbashkët, rrugën për ta parë dhe për t'u bindur, Foda e ka pasur njëjtë sikur futbollistët. Iu kam thënë të vijë t'i shohë të gjitha kushtet dhe pastaj ta shohë projektin, e pastaj e fundit ka qenë pjesa e marrëveshjes ose nënshkrimit të kontratës në anën ekonomike. Po e them anën ekonomike për faktin që

ky i ka besuar projektit dhe e ka dashur këtë projekt", është shprehur Ademi. Pos tjerash, Ademi ka thënë se Foda do të vazhdojë të shkruajë histori me Kosovën, ndërsa ka shtuar se i njëjti ka refuzuar një shumë të madhe parash për të qëndruar në Kosovë. "E ka shtëpinë këtu, jeton në Kosovë, rri, punon. Është shumë i interesuar ta ngrejë futbollin në Kosovë", ka thënë ai.

GJILANI, LIDER NË SUPERLIGËN E KOSOVËS NË FUBOLL

PRISHTINË, 24 GUSHT - Gjilani ka nisur në mënyrën më të mirë kampionatin e ri, duke shënuar edhe fitoren e dytë radhazi në Albi Mall Superligën e Kosovës. Skuadra gjilanase ka triumfuar si mysafire ndaj Llapit me rezultat 2:0, në përballjen e zhvilluar, të dielën, në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Protagonisti kryesor i këtij takimi ishte Oltion Bilali, i cili me dy golat e realizuar në pjesën e parë vulosi triumfin e kuqebardhëve. Goli i parë ka ardhur në minutën e 19-të. Pas një aksioni të ndërthuar mirë nga mysafirët, Arbër Potoku ka asistuar për Bilalin, i cili me

një goditje të saktë me kokë e ka mposhtur portierin vendas. Gjilani e ka dyfishuar epërsinë katër minuta para përfundimit të pjesës së parë, kur Bilali ka shënuar edhe një herë, duke i dhënë skuadrës së tij një avantazh të sigurt para pushimit. Me këtë fitore, Gjilani ka marrë maksimumin e pikëve në dy xhirot e para dhe ka konfirmuar një nisje pozitive të edicionit, ndërsa Llapi ende nuk ka arritur të gjejë pikët e para në këtë kampionat. Në xhiron dytë, fitore kanë shënuar edhe Ballkani dhe Dukagjini, ku kanë mposhtur Vushtrrinë dhe Feronikelin '74. Ndërsa Malisheva dhe Drenica

kanë ndarë pikët duke luajtur baras 1:1. Kurse superderbi Drita - Prishtina është pezulluar për shkak të garave ndërkombëtare të skuadrës nga Gjilani.

RENDITJA TABELARE PAS XHIROS SË DYTË

Gjilani 6
Malisheva 4
Dukagjini 4
Drita 3
Prishtina 3
Ballkani 3
Drenica 2
Feronikeli '74 0
Llapi 0
Vushtrria 0





Prishtinë 10000 Kosovë. Rruga "TIRANA" nr. 125 Tel. +383 (0) 38 613 026

Nr. i protokollit: 828

Data: 24.08.2026

Bazuar në nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L – 138, i datës 28.02.2013 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L – 143, i datës 13.12.2012, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe në bazë të rregullores (MASHT) nr. 01/2017, të datës 02.02.2017, për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave nga aftësimi profesional dhe arsimit për të rritur, rregulloren për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) shpallë :

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) për vijimin e mësimit për të rritur në Qendrën e Kompetencës "SHTJEFËN GJEÇOVI" në Prishtinë, për vitin shkollor 2026/2027 afati i Janarit

në këto profile:

- Dirigjimi kompjuterik i makinave
- Metalpunues
- Automekanik
- Mekatronikë
- Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ngrohjes dhe klimatizimit
- Operator Prodhimi
- Floktari
- Esteticient
- Konfeksioner
- Rrobaqepës
- Transport rrugor
- Trafik rrugor
- Transpor hekurudhor (Drejtues i trenave, Lëvizje e trenave, Tërheqje e trenave).

KUSHTET:

Regjistrimi i vijuesve në programin arsimit për të rritur bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt siç është paraparë në Ligjin nr.04/L – 143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve të MASHT-it, UA 11/2011, UA 16/2011 i datës 30.12.2011 ; UA 12/2014, i datës 05.05.2014, dhe UA 13/2014, i datës 05.05.2014.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit- kandidatët të cilët kanë moshën mbi 17 vjet.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Dëftesa e klasëve të kryera paraprake
- Certifikata e lindjes
- Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të UA 11/2011, i datës 30.12.2011.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- | | |
|---|----------|
| a) Për regjistrim të vitit për një klasë | 100,00 € |
| b) Për praktikë profesionale | 50,00 € |
| c) Për provim diferencial | 10,00 € |
| d) Provimi përfundimtar/certifikata – diploma | 50,00 € |

Pagesat bëhen në institucionet financiare sipas kodit të shkollës.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Drejtori: Blerim Gërvalla

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine I Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Triple Energy me nr. të protokolit 2941/26 të datës 28.05.2026 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet Plotësim Ndryshimin e Kushteve Ndërtimore për projektin "Ndërtimi i parkut fotovoltaiik në Fushë 90MW" me infrastrukturën përcjellëse që ndodhen në Zonën Kadastrale Binxhë me numër të parcelave:

00001-21, 00001-23, 00008-3, 00008-5, 00008-7, 00008-8, 00008-9, 00008-10, 00008-11, 00008-12, 00008-13, 00008-14, 00008-15, 00008-16, 00008-17, 00018-1, 00018-2, 00018-3 dhe 00018-4 në Komunën e Klinës.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e projektit " Ndërtimi i parkut fotovoltaiik në Fushë 90MW " për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji me diell.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt. 04.09.2026 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:

Kushtet Ndërtimore të propozuara: Triple Energy **projekti**–“ Ndërtimi i parkut fotovoltaiik në Fushë 90MW " **Z.K. Binxhë - Komuna e Klinës”**

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 6, Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga era	
b. Vija rregulluese.	m’
c. Vija e ndërtimit.	5 m 10 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	5.30 m 35.5m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	5.30m 21.7 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	4.1 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	97%
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	22
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese

I. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo☐

Nuk aplikohet ☐

m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth?

Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:

n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.

- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sebastian Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L